



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 107
Prishtinë, më 28 mars 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 28 MARS 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Flora Brovina, Afërdita Berisha-Shaqiri, Glauk Konjufca, Burim Ramadani, Myzejene Selmani, Shaip Muja, Salih Morina, Afrim Hoti, Teuta Haxhiu dhe Ramiz Lladrovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Mursel Haljilji parashtroi pyetje për ministrin Dardan Gashi në lidhje me atë se a janë marrë masa nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vënien e pikave të krizës në territorin e Kosovës për t'i parandaluar derdhjet e rrjedhës së lumenjve, rrëshqitjes së gurëve në rrugë dhe ortekëve të borës gjatë dimrit.

Ministri Dardan Gashi nuk ishte e pranishëm në sallë.

Deputetja Salihe Mustafa parashtroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me përgatitjet që janë bërë për themelimin e Universitetit Publik të Gjilanit dhe se a do ta fillojë ky universitet punën në vitin e ri akademik.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Deputetja Ganimete Musliu parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me atë se a ka psikologë të punësuar në qendrat sociale që veprojnë në Kosovë.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Ganimete Musliu.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me arsyen e mospagesës së pagave për stafin akademik të angazhuar në Universitetin e Prishtinës për muajin qershor 2012.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Vjollca Krasniqi parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me arsyen e moszbatimit të Ligjit për zjarrfikje dhe shpëtim, të Udhëzimit administrativ dhe Marrëveshjes së Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave dhe komunave lidhur me transferimin e shërbimit të zjarrfikjes dhe shpëtimit.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetes Vjollca Krasniqi.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të shtatë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtari kërkimore-shkencore, inovacione dhe teknologji,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet,
10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
11. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së, mbështetur edhe nga deputetë të tjerë,
12. Zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e komuniteteve joshumicë.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mëparshme

Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, pati vërejtje në procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur me 15 dhe 19 mars 2013, duke propozuar që pas konstatimit të rezultatit të votimit për rekomandimet e GP të LDK-së lidhur me faturimin e shpenzimit të energjisë elektrike për muajin janar 2013: 35 vota për dhe 35 vota kundër, të shtohen fjalët: **“Nuk janë marrë parasysh votimet me dorë”**.

Ramë Vataj kërkoi që në transkriptin e 15 marsit 2013, në fjalën e tij për pikën nr. 1 të rendit të ditës, togfjalëshi “krim i shumëzuar” të zëvendësohet me “krim i shëmtuar”.

Me vërejtjet e lartshënuara, Kuvend i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 8 e 12 mars 2013, dhe të mbledhjes plenare të mbajtur më 14, 15 dhe 19 mars 2013.

4. Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të shtatë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta marrë fjalën.

Kryeministri Hashim Thaçi fillimisht tha se është e qartë tashmë se kemi hyrë në fazën më të ndjeshme, më substanciale dhe njëkohësisht më të vështirë për Serbinë. E them më të vështirë për Serbinë, sepse tani jemi në fazën kur Serbia duhet t'i shpërbëjë pa kushte strukturat paralele të sigurisë.

Është e qartë se ky është një ballafaqim jo i lehtë, sepse duhet të ballafaqohen me një problem që e kanë krijuar dhe ushqyer vetë tani e 13 vjet. Megjithatë, ka një pajtueshmëri edhe nga Serbia që këto struktura duhet të shpërbëhen shpejt dhe pa kushte.

Procesi i shpërbërjes së tyre do të mbikëqyrej nga një mekanizëm ndërkombëtar, sipas të gjitha gjasave nga EULEX-i, KFOR-i dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

Ne, si delegacion kemi siguruar që të gjithë ata që nuk kanë qenë të përfshirë në aktivitete kriminale do të mund të inkuadrohen më pas në institucionet e Kosovës, pasi t'i jenë nënshtruar një procesi individual të verifikimit, të bazuar në kualifikimet e tyre.

Mospajtimet më të mëdha dhe arsyeja kryesore pse edhe ky rund u përmyll pa marrëveshje janë mospajtimet fundamentale lidhur me kompetencat e asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Serbia insiston që ky asociacion të ketë kompetenca ekzekutive. Serbia synon që në Kosovë ta themelojë një nivel të tretë pushteti, duke e rrënuar kështu tërë infrastrukturën ligjore dhe kushtetuese, që me shumë mundësi e kemi ndërtuar bashkërisht.

Më lejoni të them shumë hapur dhe qartë se një gjë e tillë nuk do të ndodhë kurrë. Asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk do të lejojmë diçka që do ta cenonte rendin tonë kushtetues e ligjor.

Nuk do të zgjidhet një problem, duke e krijuar një problem tjetër edhe më të madh. Nuk do të lejojmë që në Kosovë të riciklojnë modelet e shkuara të rajonit, qoftë ajo e Republika Sërpska, ndonjë ndarje e Kosovës, ndonjë autonomi, ndonjë status special, ndonjë status i veçantë, ndonjë Ahtisari plus, apo ndonjë status i modelit të terrorit, apo Katalonisë.

Takimi i radhës është caktuar për datën 2 prill dhe Kosova shkon në Bruksel e gatshme për marrëveshje.

Marrëveshja do të përfshinte, jo vetëm çështjen e asociacionit dhe shpërbërjes pa kusht të strukturave paralele, por edhe çështje të tjera shumë të ndjeshme, si ajo e personave të pagjetur, e telekomunikacionit, energjetikës dhe çështje të tjera.

Pjesë integrale e marrëveshjes do të jetë edhe plani implementues, me agjendë, afate dhe akte të definuara qartë, për çka Kosova është e përgatitur.

Ne me të drejtë presim që në të ardhmen e afërt, pas normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, edhe KS i OKB-së të përgatisë dhe miratojë një rezolutë të re, e cila do ta bëjë Kosovën anëtare të barabartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si një shtet paqedashës dhe i gatshëm ta respektojë rendin dhe përgjegjësitë ndërkombëtare.

Për këtë kemi mbështetjen e pafund të mikut dhe partnerit tonë strategjik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjë që është konfirmuar gjatë takimit me zëvendëspresidentin Bajden, javën e shkuar në Romë, gjatë inaugurimit të Papës së ri, theksoi kryeministri.

Shteti ynë i ri është rezultat i sakrificës sonë shekullore, por edhe i partneritetit tonë shumë të fuqishëm me SHBA-të, vendet e Bashkimit Evropian dhe NATO-n.

Për këtë arsye, ne shkojmë në Bruksel me vetëbesim dhe pa frikë, përderisa i kuptoj edhe shqetësimet, por ju lus që të jemi të gjithë të përgjegjshëm. Të mos ndjellim panik e frikë, sepse nuk ka arsye për këto. Prandaj, besojuni më shumë Uashingtonit, Berlinit e Londrës, e më pak asaj që trumbetohet në mediumet e Beogradit.

Marrëveshja përfundimtare do ta marrë vulën në këtë Parlament dhe ajo që ju garantoj është se kjo marrëveshje do të jetë në dobi të Kosovës dhe së ardhmes së saj euroatlantike.

Pas raportimit të kryeministrit Thaçi, kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Bajrami, në emër të Grupi Parlamentar të PDK-së, tha se tani më jemi afër në fazën e finalizimit e një procesi shumë të rëndësishëm, i cili do t'u japë fund destruksioneve të Serbisë në Kosovë, do ta hapë rrugën e normalizimit të raporteve me Serbinë dhe do ta hapë një agjendë evropiane për Kosovën.

Grupi ynë Parlamentar i jep një mbështetje të plotë vazhdimit të procesit dhe është e sigurt se ky proces do t'i mbrojë interesat kombëtare, do ta mbrojë rendin unik kushtetues dhe Qeveria është plotësisht duke vepruar konform edhe me Rezolutën e Kuvendit të Kosovës.

Tani më po shihet se sa kanë qenë spekulative thëniet apo idetë që nga ky proces do të krijohet një status special, një Republika Sërpska, një Ahtisari plus, dhe po shihet se këto kanë qenë krejtësisht të pabaza, sepse ne, jo një herë, por disa herë e kemi thënë në këtë Kuvend që çdo ide e tillë do ta përmbyste krejt sistemin tonë kushtetues dhe idetë e tilla janë plotësisht të papranueshme, sepse Kosova i ka bërë të gjitha kompromiset e mundshme me rastin e shpalljes së pavarësisë dhe është jashtëzakonisht mirë që ne po e ruajmë partneritetin dhe koordinimin me partnerët tanë strategjikë, me të cilët edhe e kemi shpallur pavarësinë, dhe është plotësisht një praktikë e mirë që me ata që e kemi krijuar shtetin, me ata po e zgjidhim edhe problemin e mbetur të shtetkrijimit, problemin e veriut, dhe jemi të sigurt se ky proces do të mbështetet nga

bashkësia ndërkombëtare dhe do të mundësojë që vërtet atje të funksionalizohet sovraniteti dhe integriteti kushtetues.

Në fund, në emër të Grupit Parlamentar, ai paraqiti katër sugjerimet për delegacionin e Kosovës, që kanë të bëjnë me garancitë e fuqishme ndërkombëtare, planin e qartë të implementimit, Bashkimi Evropian të ketë qasje shumë më afirmative ndaj Kosovës dhe ta trasojë një rrugë të integritetit evropian dhe çështjen e draftimit të një rezolute për Këshillin e Sigurimit, me të cilën do të fuqizohej dhe do të nxirrej jashtë fuqie Rezoluta 1244.

Sabri Hamiti, në emër të Grupi Parlamentar të LDK-së, tha se sikur të pajtohemi aty për aty me fjalët e artikuluar të kryeministrit, do të thoshim se ne jemi në një fillim festiviteti. Unë besoj që nuk jemi, por sido që të jetë i mirëpres vlerësimet e tij për rezultatet që ai thotë se janë arritur deri më sot në këtë dialog. Unë edhe një herë tjetër, duke folur për këtë temë, sepse është temë që po flitet në Kuvend për herën e shtatë, për çdo rund ne jemi takuar dhe kemi biseduar këtu me kryeministrin, që puna e fjalëve, edhe kontrata e fjalës, ka mbaruar atëherë kur është bërë e pabesueshme dhe ka kaluar në shkrim në ligje, në dokumente.

Në vazhdim, ai iu referua të vetmit dokument që ka Kuvendi i Republikës së Kosovës për këtë dialog, e kjo është Rezoluta, pra bazuar në të, të gjitha këto qëndrime që janë fiksuar nga delegacioni i Kosovës të bëhen tekst dhe të vijnë në Parlament, dhe ky është detyrim. Është detyrim, sepse ne po themi se po shkojmë kah fundi i këtyre bisedimeve, ne po themi, bashkë me kryeministrin, që ky 2 prilli është dita kur vendoset, Dita D për Kosovën.

Unë personalisht mendoj që nuk është Dita D për Kosovën, por unë jam njeri që i respektoj detyrimet institucionale. Pse nuk është dita D? Nuk është e thënë që kjo marrëveshje do të duhej të bëhej vetëm me dy, e assesi me tre, katër ose pesë.

Më pas, deputeti Sabri Hamiti iu referua një dokumenti prej tetë pikave, të cilat thuhet se u janë vënë delegacioneve nga BE-ja, atëherë le t'i silllet Kuvendit ky tekst, të dihet që është ofertë zyrtare në dialog, interpretimet ose vërejtjet zyrtare të delegacionit tonë dhe bashkë me të tutje.

Liburn Aliu, në emër të Grupi Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, në lidhje me fjalën e kryeministrit e shtroi çështjen se a është ky raportim. Për të deklaruar më pas se ky nuk është raportim. Kjo është një farsë që po quhet raportim. Ne realisht nuk po dimë në fakt asgjë se çfarë ka ndodhur. Ne sot po mund vetëm të diskutojmë e të flasim mbi ato çfarë është publikuar në media deri tani, e që ka qenë një dokument me 10 pika, pastaj ka qenë një dokument me 8 pika.

Thuhet që kompetencat e komunave, të cilat i kanë ato, do t'i barten asociacionit. Nëse këto kompetenca të komunave i barten asociacionit, kjo i bie që po krijohet niveli i tretë, sepse një nivel i mesëm do t'i ketë kompetencat, të cilat i ka komuna. Të gjitha komunat bashkë do t'i definojnë kompetencat e tyre nëpërmjet asociacionit. Kjo nuk është gjë tjetër, përpos edhe më tej se autonomia.

Pra, ky asociacion do të ketë burim të veçantë të financave, përveç pikave doganore, do të ketë menaxhim të veçantë. Ky është niveli i tretë. Nuk mund të jetë nivel qendror, sepse Ministria e Financave nuk po ia jep drejtpërdrejt secilës komunë, veç e veç. Por, në mënyrë të përbashkët po menaxhohen financat për këtë asociacion, e kjo pra është e ndarë në vija etnike.

Dhe, lëshim pas lëshimi, tani kemi arritur në pikën, kur po diskutojmë për dokumente të ndryshme.

Kosova, pra, po ndahet ne dy pjesë, në pjesën serbe dhe në atë multietnike, ku njëra pjesë ka më shumë pavarësi sesa tjetra. Pjesës serbe nuk mund t'i imponojë askush asgjë, e as autoriteti qendror në Prishtinë, ndërsa pjesa tjetër multietnike mbetet e varur nga vetoja edhe për çështjet e brendshme nga pjesa serbe.

Ardian Gjini, në emër të Grupi Parlamentar të AAK-së, tha se kjo pikë e rendit të ditës pas çdo raportimi të kryeministrit po shkon sikur po përsëritet prej javës në javë.

Në vazhdim, ai tha se çfarëdo marrëveshje që arrihet është obligative të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës dhe ky Kuvend e ka procedurën e vet të ratifikimit dhe e mban të drejtën të pajtohet ose jo dhe mendoj se të gjithë duhet ta dimë se kjo është temë tepër serioze.

Në fund, ai tha se po përmendet shpesh Dita D, për të konstatuar se kjo nuk është analogji e mirë.

Myzejene Selmani, në emër të Grupi Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, tha se raportimi i kryeministrit është në pajtim me Rezolutën, e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës, dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila obligon që të jetë pjesë e këtyre bisedimeve dhe të raportojë në Kuvendin e Kosovës.

Më pas, ajo theksoi se çështja e bisedimeve është çështje edhe për asociacionin e komunave, edhe për çështjen e telekomunikacionit, të energjetikës, të personave të pagjetur, mirëpo esencialja e gjithë këtij raportimi të kryeministrit ishte çështja e një rezolute për shfuqizimin e Rezolutës 1244 dhe ne si Grup Parlamentar kërkojmë që ajo të shfuqizohet dhe Kosovës t'i hapet rruga në OKB, që të pranohet sa më shpejt.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Rada Trajković, zv/kryeministri Hajredin Kuçi, zv/kryeministri Slobodan Petrović, Halit Krasniqi, Sadri Ferati, Hydajet Hyseni, Arben Gashi, Arsim Bajrami, Sabri Hamiti, kryeministri Hashim Thaçi, Glauk Konjufca, ministri Enver Hoxhaj, Bekim Haxhiu, Lutfi Haziri, Alma Lama, Haki Demolli, Afrim Kasolli, Fadil Demaku, Albin Kurti, Teuta Sahatqija dhe Visar Ymeri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Ministri Ferid Agani, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ky projektligj i përcakton kushtet dhe rregullat për kryerjen e transplantimit të indeve dhe qelizave në fushën e mjekësisë për njerëz.

Në vazhdim, ai theksoi se projektligji i rregullon procedurat, në bazë të të cilave komisioni etik, bankat për indet dhe qelizat, institucionet shëndetësore, organet tjera dhe personat e autorizuar duhet të veprojnë në çështjet e transplantimit të indeve dhe qelizave.

Më pas, ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Salihe Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Nazane Breca, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision FunkSIONAL dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Idriz Vehapi, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 56,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Idriz Vehapi, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Sabri Hamiti, Ramë Vataj, ministri Ramë Buja, Teuta Haxhiu, Muhamet Mustafa, Arsim Bajrami, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Jakup Krasniqi, Armend Zemaj, Halit Krasniqi dhe Idriz Vehapi, diskutimi i plotë i të cilëve është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12,13,14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40 - i riformuluar, 41, 42, 43, 44, 45 dhe 46.

Kuvendi nuk e miratoi asnjërin prej dy propozimeve për amendamentin nr. 5.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 73,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për veprimtari kërkimore dhe shkencore.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Zenun Pajaziti, ministri Besim Beqaj, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Teuta Sahatqija, Sala Berisha-Shala, diskutimi i plotë i të cilëve është dhënë në transkript.

Kryetari i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 12,13,14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39 dhe 40.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin nr. 10, amendamentin nr. 11A, amendamentin nr. 11B dhe amendamentin nr. 30.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 44,
Kundër ----- 16,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet.

10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, tha se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25 mars 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri

në mbledhjen e sotme plenare t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.
Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve.

Në vazhdim, kryetari i ftoi kryetarët /përfaqësuesit/ e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc.

Grupet parlamentare i propozuan këta anëtarë:

GP i PDK-së i propozoi deputetët: Xhevahire Izmaqu dhe Idriz Vehapi;
GP i LDK-së i propozoi deputetët: Lirije Kajtazi dhe Ali Sadriu;
GP i Lëvizjes "Vetëvendosje" e propozoi deputeten Albulena Haxhiu;
GP i AAK-së e propozoi deputeten Teuta Haxhiu;
GP i Koalicionit Kosova e Re e propozoi deputetin Jeton Svirca;
GP i SLS-së e propozoi deputetin Jelena Bontiq, si dhe
GP "6+" e propozoi deputetin Fikrim Damka.

Pas këtyre propozimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin e grupeve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 65,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaqu nga PDK, kryesuese,
2. Lirije Kajtazi nga LDK, zv/kryesuese,
3. Idriz Vehapi nga PDK, anëtar,
4. Ali Sadriu nga LDK, anëtar,
5. Albulena Haxhiu nga "Vetëvendosje", anëtar,
6. Teuta Haxhiu nga AAK, anëtar,
7. Jeton Svirca, nga Koalicioni Kosova e Re, anëtar,
8. Jelena Bontiq nga SLS, anëtar,
9. Fikrim Damka nga "6+", anëtar.

II. Komisioni Parlamentar ad hoc, në bazë të nenit 26 pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, duhet t'i shqyrtojë dhe t'i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

11. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK- së, mbështetur edhe nga deputetë të tjerë

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se Grupi Parlamentar i LDK-së, i mbështetur edhe nga deputetë tjerë, në bazë të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës së

Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 3 të Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar, nenit 69 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohës së llogaritjes sipas tarifës së lirë, njehsorëve digjitalë dhe masave të ndërmarra në lidhje me këtë rast.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën për formimin e Komisionit për Hetim Parlamentar. Ai e propozoi deputetin Muhamet Mustafa për anëtar dhe kryesues të Komisionit.

Diskutimi i deputetit Ismet Beqiri është dhënë i plotë në transkript.

Në vazhdim, kryetari theksoi se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25 mars 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në mbledhjen e sotme plenare t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar.

Komisioni përbëhet prej 11 anëtarëve.

Grupet parlamentare i propozuan deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar.

Pasi GP i propozuan anëtarët për Komisionin Hetimor Parlamentar, kryetari i hodhi në votim.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë absolute të votave të deputetëve, mori këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me:
 - faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013,
 - kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë,
 - njehsorët digjitalë dhe
 - masat e ndërmarra në lidhje me këtë rast.
2. Komision themelohet në përbëje, si në vijim:
 1. Muhamet Mustafa, deputet pa GP, kryesues,
 2. Teuta Sahatqija, nga GP i LDK-së, zv/kryesues,
 3. Ramiz Lladrovci, nga GP i PDK-së, anëtar,
 4. Behar Selimi, nga GP i PDK-së, anëtar,
 5. Fadil Demaku, nga GP i PDK-së, anëtar,
 6. Ali Sadriu, nga GP i LDK-së, anëtar,
 7. Visar Ymeri, nga GP VV,
 8. Donika Kadaj-Bujupi, nga GP i AAK-së,
 9. Suzana Novobërdaliu, nga GP i KKR-së,
 10. Goran Marinkoviq, nga GP i SLS-së, anëtar dhe
 11. Albert Kinolli nga GP "6+", anëtar.
3. Komisioni Hetimor Parlamentar, në pajtim me Ligjin për hetim parlamentar, duhet ta hetojë çështjen e ngritur dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin përfundimtar në afat prej dy (2) muajve nga dita e themelimit.

12. Zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e komuniteteve joshumicë

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, tha se deputeti Enis Kervan ka njoftuar për lirim të pozitës së nënkryetarit të Kuvendit, pas kërkesave të deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë.

Në vazhdim, ai e ftoi deputeten Myfera Shinik, kryetare e Grupit Parlamentar “6+”, që para Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë njoftimin e këtij grupi parlamentar për marrëveshjen e arritur për caktimin e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit nga radha e deputeteve nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë. Ajo i propozoi Kuvendit deputetët: Rasim Demiri dhe Albert Kinolli, që me rotacion të emërohen në pozitën e nënkryetarit të Kuvendit.

Më pas, kryetari e hodhi në votim propozimin për zgjedhjen z. Rasim Demiri nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 45,
Kundër ----- 6,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi kërkesën për zgjedhjen e z. Rasim Demiri nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radha e të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes plenare në orën 18:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale